

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: NDRIÇIMI I RRUGËS BAHÇALLEK - HARKU I BËRDICËS

Ky projekt është përgatitur duke zbatuar normat CE, e veçanërisht ato CEI që janë startandizuar me ato të Komunitetit European. Gjithashtu materialet që do të zgjidhen për të zbatuar këtë projekt janë specifikuar si prodhime të standartizuara.

Rruga ndodhet në zonën jugore të qytetit të Shkodrës. Segmenti që trajtohet në këtë projekt fillon tek ura e Bahçallekut dhe përfundon tek harku i Berdicës. Gjerësia e karraxhates është 7-10 m. Në të dy anët e rrugës ka segmente që janë ndërtuar trotuare me gjërësi që varjon nga 1 deri në 2 m. Në fillim dhe fund të rrugës ka ndriçim funksional dhe në gjëndje të mirë. Rruga ka karakter inter-urban me trafik të lartë automjesh. Gjithashtu në këtë rrugë ka një numër të lartë kryqëzimesh.

Ndriçimi i rrugës është i menduar të bëhet me 46 shtylla metalike me lartësi 9.8 m, që në zhvillimin linear do të vendosen në distancë 25-35 m. Do të perdoren një sasi prej 15 shtyllash ekzistuese pasi janë brenda kushteve optimale. Kalimi i kabllit do të bëhet me tub plastik me diametër 75mm.

Sistemi i ndriçimit do të ushqehet me energji elektrike me tension të ulët. Kabllot e shpërndarjes në këtë sistem do të zgjidhen sipas normative, kabell bakri $3 \times 1.5 \text{ mm}^2$, për lidhjet elektrike ndriçuesit rrugor me linjën kryesore, si dhe kabell bakri $4 \times 6 \text{ mm}^2$ dhe kabell alumini $4 \times 16 \text{ mm}^2$ për linjën kryesore. Të gjitha duhet të kenë vetinë që nuk ndihmojnë zjarrin e nuk prodhojnë gaze helmuese gjatë vetëdijegies.

Lidhja e rrjetit të ndriçimit me rrjetin elektrik të shpërndarjes do të bëhet në dy kabina "Baçallek | SH1888" dhe "Baçallek 2 TR2".

Panelet e komandimit do të vendoset pranë kabinave elektrike.

Pjesët e dëmtuara nga shtrirja e tubave do të riktheht në gjëndjen e parandërhyrjes.

Pergatiti
Ing. Elsid Sadiku